



MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR RROGOZHINË

Nr. 487 Prot.

Rrogozhinë, më 21.08. 2026

Lënda: Njoftim për dorëzimin e aplikimeve për punësim për kandidatët jashtë portalit “Mësues për Shqipërinë”

Në zbatim të udhëzimit të MAS nr 8 dt 03.05.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend i lirë pune si dhe administrimit të portalit Mësues për Shqipërinë”, I ndryshuar, në Rast se për pozicionet e lira të punës Brenda një ZVAP-I nuk paraqiten kandidatë nga portali Mësues për Shqipërinë në nivel ZVAP -I dhe DRAP-I do të vijohet nga ana e ZVAP-së me kandidatë të tjerë të interesuar që kanë paraqitur kërkesën dhe janë renditur sipas pikëve në listë pritjeje.

ZVAP Rrogozhinë njofton kandidatët e interesuar të cilët nuk janë pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë”, por plotësojnë kushtet ligjore për ushtrimin e profesionit të mësuesit, të paraqesin dokumentacionin në adresën fizike të ZVAP Rrogozhinë.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë për punësim
- CV të përditësuar
- Raport mjeko-ligjor I përditësuar
- Dëshmi penaliteti
- Kopje e librezës së punës e njehësuar me origjinalin (nëse ka)
- Kopje e njehësuar me origjinalin e diplomës/diplomave, vërtetit/listës së notave të studimeve të lartë cikli I parë, cikli I dytë dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë ose të barazvlefshme me to sipas përcaktimeve ligjore në fuqi (e detyrueshme)
- Kopje e njehësuar me origjinalin e licensës (Provimit të shtetit nëse ka)
- Kopje e njehësuar me origjinalin e dëshmisë së kualifikimit të fundit (nëse ka)
- Kopje e njehësuar me origjinalin e certifikatave me kredite (nëse ka)
- Kopje e njehësuar me origjinalin e dëshmisë së njohjes së gjuhës/gjuhëve të huaja (nëse ka)

Dorëzimi i dokumentacionit kryhet në ZVAP rrogozhinë nëpërmjet shërbimit postar deri më datë 31.08.2026

Pas përfundimit të afatit të aplikimit dokumentacioni do të shqyrtohet nga komisioni përgjegjës.

Kandidatët do të renditen në listën e pritjes e cila do të publikohet në faqe zyrtare të ZVAP Rrogozhinë dhe do të përditësohet gjatë gjithë vitit shkollor, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Duke ju falenderuar



Adresa: Lagja Nr.2 Rrogozhinë

email: ZVArrogozhine@arsimi.gov.al